UDHËZIM
Nr. 34, datë 10.9.2018

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 45, DATË 19.7.2018 "PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË NDRYSHIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DUKE VEPRUAR NËPËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE DHE TRANS ADRIATIK PIPELINE AG, LIDHUR ME MARRËVESHJEN ME QEVERINË E VENDIT PRITËS"

Në mbështetje të nenit 102, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, të ligjit nr. 45, datë 19.7.2018, "Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me Marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës", ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

1. Importi dhe furnizimi brenda vendit i mallrave dhe shërbimeve në lidhje me aktivitetet e ndërtimit gjatë fazës së ndërtimit të projektit (siç përcaktohet në Marrëveshjen e Qeverisë Pritëse (MQP), e ndryshuar) do t'i nënshtrohet trajtimit të veçantë të TVSH-së, që nënkupton aplikimin e skemës së autongarkesës së TVSH-së (*reverse-charge*) për furnizime të caktuara të mallrave dhe shërbimeve, siç përcaktohet në ligjin nr. 45, datë 19.7.2018, dhe në këtë udhëzim.

2. Për qëllimet e zbatimit të këtij trajtimi të veçantë të TVSH-së, siç përcaktohet në pikën 24.15 të MQP-së, të ndryshuar, Investitori i Projektit do të propozojë deri në 80 kontraktues të nivelit të parë dhe kontraktues të nivelit të dytë (në çdo kohë) dhe do të ketë, gjithashtu, të drejtën që në një fazë të mëvonshme të zëvendësojë çdo kontraktues të nivelit të parë dhe kontraktues të nivelit të dytë të propozuar. Numri i kontraktuesve të propozuar në çdo periudhë kohore nuk duhet të tejkalojë numrin 80.

- Kontraktuesi i nivelit të parë, nënkupton çdo person dhe filialet e tij sipas kuptimit në ligjin nr. 116/2013, datë 15.4.2013, që furnizojnë mallra dhe/ose shërbime për Investitorin e Projektit, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me kontratë, nënkontratë ose në ndonjë mënyrë tjetër të përcaktuar në legjislacionin shqiptar, por duke përjashtuar çdo individ që vepron në rolin e tij ose të saj si punonjës i ndonjë personi tjetër;
- Kontraktuesi i nivelit të dytë, do të thotë çdo person me të cilin kontraktuesi i nivelit të parë ka një marrëveshje për të kryer detyra specifike në ofrimin e furnizimit të mallrave dhe/ose shërbimeve për Investitorin e Projektit.

2.1 Investitori i Projektit dorëzon propozimin mbi listën fillestare të kontraktuesve në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), si dhe kopjet e kontratave që Investitori i Projektit ka lidhur me secilin nga kontraktuesit e nivelit të parë së bashku me një kopje të certifikatës së tyre të NIPT-IT/NUIS-it dhe kopjet e kontratave të lidhura midis kontraktuesve të nivelit të parë dhe kontraktuesve të nivelit të dytë.

Investitori i Projektit dorëzon në DPT edhe listën e kontraktuesve të përditësuar herë pas here, bazuar në nevojat e veprimtarisë, derisa numri në listë të arrijë numrin 80 të kontraktuesve, sipas procedurës së paraqitur në paragrafin 2.2 më poshtë. Lista fillestare dhe listat e përditësuara të kontraktuesve të nivelit të parë dorëzohen, gjithashtu, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD).

2.2 Në rast të zëvendësimit ose largimit të kontraktuesve nga lista e kontraktuesve të nivelit të parë dhe të dytë brenda numrit 80, Investitori i Projektit duhet të dorëzojë propozimin mbi listën e kontraktuesve të përditësuar pranë autoriteteve tatimore. Këto ndryshime bëhen efektive tre javë pas dorëzimit të listës së përditësuar të kontraktuesve nga ana e Investitorit të Projektit. Lista do të dorëzohet në DPT dhe DPD, rast pas rasti.

Me bërjen efektive të zëvendësimeve ose largimeve në listën e përditësuar të kontraktuesve, kontraktuesi i çregjistruar nga kjo listë nuk është më subjekt i trajtimit të veçantë të TVSH-së, të përcaktuar në ligjin nr. 45/2018, por u nënshtrohet dispozitave të përgjithshme të ligjit "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë".

Çdo kontraktues i nivelit të parë dhe të dytë i hequr nga lista e kontraktuesve nga Investitori i Projektit mund të ripropozohet dhe të ripërfshihet në listën e kontraktuesve në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 45/2018, dhe këtij udhëzimi.

2.3 Nëse Investitori i Projektit kërkon shtimin e kontraktuesve të rinj, përveç 80 (tetëdhjetë) kontraktuesve të përmendur më sipër, duhet t'i drejtohet Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë DPT-së për të miratuar kontraktuesit e rinj, duke paraqitur një kërkesë të argumentuar mbi nevojën e shtimit të kontraktuesve të rinj dhe duke i bashkëlidhur kësaj kërkese dhe kopje të kontratës së lidhur mes palëve.

Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT, për dhënien e miratimit, bashkëpunon me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve që administron kontraktuesin e ri. DPT-ja jep një përgjigje për Investitorin e Projektit brenda katër javëve nga paraqitja e kërkesës. Dhënia e miratimit nuk mund të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme.

2.4 Nëse Investitori i Projektit vendos të zëvendësojë një nga kontraktuesit shtesë (mbi numrin 80) me një kontraktues tjetër, ai paraqet një kërkesë, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor pranë DPT-së, për miratimin e zëvendësimit me kontraktuesin e ri. Investitori i Projektit për çdo rast, duhet të paraqesë arsyet për zëvendësimin e kontraktuesit të mëparshëm.

Drejtoria e Kontrollit Tatimor pranë DPT-së, edhe në këtë rast, për dhënien e miratimit bashkëpunon me drejtoritë rajonale të tatimeve që administrojnë kontraktuesin e ri dhe kontraktuesin e zëvendësuar. DPT-ja i kthen përgjigje Investitorit të Projektit brenda katër javëve nga paraqitja e kërkesës. Ky miratim nuk mund të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme. Me bërjen efektive të zëvendësuesit në listën e kontraktuesve, kontraktuesi i çregjistruar nga lista e kontraktuesve, nuk është më subjekt i trajtimit të veçantë të TVSH-së, siç është përcaktuar në ligjin nr. 45/2018, por i nënshtrohet dispozitave të përgjithshme të ligjit "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë".

3. Për importimin gjatë fazës së ndërtimit të të gjitha makinerive dhe pajisjeve, linjave teknologjike, automjeteve, lëndëve të para, pjesëve të këmbimit dhe çdo malli tjetër që lidhet me projektin, në atë masë që këto importe nuk janë të përjashtuara sipas ligjit të TVSH-së dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, importuesi (Investitori i Projektit/kontraktuesi i nivelit të parë) nuk do të ketë detyrim për pagesën pranë autoriteteve doganore, të tatimit mbi vlerën e shtuar që duhej kryer në lidhje me këto importe. Pra, për importimin e mallrave që nuk janë të përjashtuara në bazë të dispozitave të ligjit "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore të tij, do të zbatohet regjimi i veçantë i TVSH-së, i përcaktuar në ligjin nr. 45/2018 dhe në këtë udhëzim. Ky import mallrash do të trajtohet si një furnizim mallrash i kryer nga importuesi për veten e tij, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike, me efekt lindjen e detyrimit të importuesit për të paguar këtë tatim mbi vlerën e shtuar ndaj administratës tatimore dhe të drejtën e tij për të zbritur këtë tatim mbi vlerën e shtuar.

3.1 Importuesi, në përputhje me paragrafin 3 më sipër, lëshon një faturë tatimore shitjeje për vete, ku do të rezultojë si furnizues dhe blerës i mallrave në të njëjtën kohë (autongarkesë) dhe ka të drejtën që menjëherë të zbresë nga TVSH-ja e llogaritur mbi shitjet që korrespondojnë me këto importe, TVSH-në e zbatuar në këto blerje në të njëjtën vlerë. Pra, nuk do të bëhet një pagesë me para në dorë tek autoritetet tatimore, me kusht që importuesi të ketë të drejtë të zbresë TVSH-në për blerjet sipas dispozitave të përgjithshme të aplikueshme të ligjit të TVSH-së.

Fatura tatimore e përgatitur sipas këtij paragrafi, regjistrohet njëkohësisht në librin e blerjeve dhe shitjeve të TVSH-së. Më konkretisht, vlera e tatueshme dhe TVSH-ja mbi importin do të deklarohen

në librin e shitjeve në kolonat [19] dhe [20] "Autongarkesë TVSH-së në shitje (*reversë-charge*)". Fatura e njëjtë do të deklarohet edhe në librin e blerjeve në kolonat [38] dhe [39] "Autongarkesë e TVSH-së në blerje me të drejtë kreditimi (*reverse-charge*)".

Gjithashtu, për qëllimin e vetëm të deklarimit të importit, dokumenti i vetëm administrativ përkatës do të deklarohet në librin e blerjes në kolonën "Importe të përjashtuara të investimit pa TVSH" me ngjyrë të kuqe, por nuk do të merret në konsideratë kur të llogariten blerjet e Investitorit të Projektit ose kontraktuesit të nivelit të parë.

3.2 Investitorit të Projektit apo kontraktuesit të nivelit të parë i lëshohet deklarata doganore (DAV) e importit (IM4), me një numër regjistrimi R. Një kod plotësues (për trajtimin e veçantë të TVSH-së sipas ligjit nr. 45/2018), shtohet në kutinë nr. 37 të DAV-së. Në kutinë nr. 47 (llogaritja e detyrimeve) të DAV, kolona MP, në zërin TVSH shënohet një numër i veçantë nga administrata doganore, që nënkupton mospagesën e TVSH-së në momentin e importit. Prandaj, në totalin e detyrimeve që duhet paguar, paraqitet vetëm shuma e detyrimeve doganore.

Në momentin e importit, për çdo regjistrim, do të shprehet qartë "Importi sipas trajtimit të veçantë të TVSH-së në përputhje me ligjin nr. 45/2018, referuar deklaratës doganore nr. ___ , datë ___".

3.3 Kontraktuesi i nivelit të parë ose Investitori i Projektit sipas këtij udhëzimi, për importin e parë të kryer do të dorëzojë pranë autoriteteve doganore:

a) Një kërkesë me shkrim për zbatimin e dispozitave të këtij udhëzimi;

b) Një kopje të certifikatës së NIPT/NUIS-it;

c) Një kopje të kontratës së lidhur me Investitorin e Projektit, ku jepen detaje mbi mallrat, sasitë dhe degët e kontraktuesve të nivelit të parë që do të furnizojnë mallrat për t'u importuar.

3.4. Trajtimi i importeve, siç përcaktohet më sipër në paragrafët 3 deri në 3.3, nuk ndikon në të drejtën e importuesit për të zbritur TVSH-në për blerjet (mbi bazën e autongarkesës, të lëshuar siç është paraqitur në paragrafin 3.1 më sipër) njësoj sikur importi i kryer nga ai të ishte një importim i tatueshëm sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë".

4. Për sa u përket furnizimeve brenda vendit të mallrave dhe shërbimeve të kryera të lidhura me projektin dhe të kryera gjatë fazës së ndërtimit nga kontraktuesit e nivelit të parë dhe kontraktuesit e nivelit të dytë, vetëm personi për të cilin kryhen furnizimet, do të jetë përgjegjës për deklarimin si të pagueshëm tek autoritetet tatimore të çdo detyrimi TVSH-je dhe do të ketë të drejtë për të zbritur këtë TVSH përmes skemës së autongarkesës (*reverse-charge*), në përputhje me dispozitat e përgjithshme të ligjit të zbatueshëm të TVSH-së. Në këtë rast, në faturat e lëshuara nga furnizuesi për furnizimet, nuk llogaritet dhe pasqyrohet TVSH-ja. Një trajtim i tillë i furnizimeve nuk do të ndikojë në të drejtën e furnizuesit për të zbritur TVSH-në për blerjet, në mënyrë të njëjtë sikur furnizimi i kryer nga ai të ishte një furnizim i tatueshëm sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit të TVSH-së.

Kjo procedurë është e zbatueshme vetëm për furnizime të kryera nga kontraktorët e nivelit 1 dhe kontraktorët e nivelit 2.

4.1 Marrësi i këtyre furnizimeve, që sipas rastit do të jetë Investitori i Projektit ose kontraktuesi i nivelit të parë, do të lëshojë një faturë tatimore shitjeje për veten e tij ku do të rezultojë si furnizues (shitës) dhe marrës (blerës) i mallrave dhe shërbimeve në të njëjtën kohë (autongarkesë) dhe ka të drejtën të zbresë menjëherë nga TVSH-ja e llogaritur mbi shitjet që i korrespondojnë këtyre furnizimeve të mallrave ose shërbimeve, TVSH-në e zbatuar në këto blerje, në të njëjtën vlerë, pra nuk do të bëhet pagesë në administratën tatimore, me kusht që personi të cilit i janë kryer furnizimet të ketë të drejtën të zbresë këtë TVSH në blerje, sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit të TVSH-së.

4.2 Furnizimet e kryera ndërmjet një pale të tretë dhe një kontraktuesi të nivelit të dytë kur ky i fundit është marrësi i mallrave ose shërbimeve dhe pavarësisht nëse ato janë të lidhura me aktivitetet e ndërtimit gjatë fazës së ndërtimit të projektit, nuk i nënshtrohen trajtimit të veçantë të TVSH-së sipas këtij udhëzimi. Këto furnizime u nënshtrohen dispozitave të përgjithshme të ligjit "Për tatimin

mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

4.3 Për furnizimet e kryera nga kontraktuesi i nivelit të dytë te kontraktuesi i nivelit të parë, kontraktuesi i nivelit të dytë do të lëshojë një faturë tatimore, pa llogaritur apo deklaruar TVSH-në në faturë, pasi furnizimet e kryera nga kontraktuesi i nivelit të dytë janë të tatueshme me TVSH, por detyrimin për të llogaritur, deklaruar dhe paguar TVSH-në për këto furnizime e mban përfituesi (blerësi) i këtyre furnizimeve. Kontraktuesi i nivelit të dytë do të regjistrojë faturat e shitjes në librin e shitjeve në kolonën "Shitje pa TVSH".

4.4 Për vlerën e furnizimeve të kryera nga kontraktuesi i nivelit të dytë, sipas faturës së lëshuar në përputhje me paragrafin 4.3, kontraktuesi i nivelit të parë do të lëshojë një faturë tatimore shitjeje për vete, kur ai do të rezultojë si furnizues (shitës) dhe marrës (blerës) i mallrave dhe shërbimeve në të njëjtën kohë (autongarkesë). Kontraktuesi i nivelit të parë do të deklarojë në librin e blerjes respektivisht në kolonat [38] dhe [39] "Autongarkesë e TVSH-së në blerje me të drejtë kreditimi (*reversë-charge*)", vlerën e tatueshme dhe TVSH-në e paraqitur në këtë faturë, me kusht që kontraktuesi i nivelit të parë të ketë të drejtën të zbresë këtë TVSH për blerjet sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit të zbatueshëm të TVSH-së. Në të njëjtën kohë, vlera e tatueshme dhe TVSH-ja do të deklarohen në librin e shitjeve në kolonat [19] dhe [20] "Autongarkesë TVSH-së në shitje (*reversë-charge*)".

4.5 Fatura tatimore e lëshuar nga kontraktuesi i nivelit të dytë do të regjistrohet dhe deklarohet në librin e blerjeve të kontraktuesit të nivelit të parë në kolonën [25] "Blerje investimi brenda vendit pa TVSH", me ngjyrë të kuqe, vetëm për qëllime të evidentimit dhe rakordimit nga administrata tatimore, por nuk do të merren parasysh për qëllimet e llogaritjes së blerjeve të përgjithshme të kontraktuesit të nivelit të parë.

4.6 E njëjta procedurë do të zbatohet nga kontraktuesi i nivelit të parë që furnizon mallra dhe/ose shërbime në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për Investitorin e Projektit. TVSH-ja nuk do të llogaritet dhe faturohet në faturën tatimore të lëshuar nga kontraktuesi i nivelit të parë tek Investitori i Projektit. Kontraktuesi i nivelit të parë do ta deklarojë këtë faturë në librin e shitjeve në kolonën "Shitje pa TVSH". Investitori i Projektit do të lëshojë një faturë shitjeje për vete (autongarkesë), e cila do të deklarohet në librat e TVSH-së, siç është paraqitur në paragrafin 4.4 më sipër.

4.7 Trajtimi i furnizimeve siç përcaktohet në paragrafët 4.1 deri 4.6, nuk ndikon në të drejtën e furnizuesit për të zbritur TVSH-në për blerjet në mënyrë të njëjtë sikur këto furnizime të ishin furnizime të tatueshme me TVSH sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit të TVSH-së.

5. Faturat saktësuese (nota e kreditit/nota e debitit) të lëshuara në përputhje me nenin 41 të ligjit të TVSH-së do të trajtohen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë si fatura për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të përmendura në paragrafët 3 dhe 4, të këtij udhëzimi. Faturat e lëshuara në përputhje me nenin 97, të ligjit të TVSH-së, për pagesa të arkëtuara përpara se të kryhet furnizimi i mallit ose përpara përfundimit të furnizimit të shërbimit, do të trajtohet në të njëjtën mënyrë dhe procedurë si fatura për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të përmendura në paragrafët 4 të këtij udhëzimi.

6. Nëse Investitori i Projektit, kontraktuesi i nivelit të parë ose kontraktuesi i nivelit të dytë kryejnë furnizime mallrash ose shërbimesh për palë të treta për të cilat nuk zbatohet i veçantë i TVSH-së (*reverse-charge*), siç përcaktohet në këtë udhëzim, ata do të lëshojnë një faturë tatimore në përputhje me dispozitat e përgjithshme të ligjit të TVSH-së.

7. Nëse furnizimet brenda vendit të mallrave ose shërbimeve të kryera nga kontraktuesi i nivelit të parë ose kontraktuesi i nivelit të dytë, janë të përjashtuara nga TVSH-ja në bazë të dispozitave të përgjithshme të ligjit të TVSH-së, atëherë dispozitat e këtij udhëzimi nuk zbatohen për këto furnizime, që do të thotë se këto furnizime nuk do t'i nënshtrohen skemës së autongarkesës nga marrësi i furnizimit.

Gjithashtu, llojet e furnizimeve të mallrave dhe shërbimeve, të cilat furnizohen prej kontraktuesve të nivelit të parë dhe të dytë duke mos aplikuar TVSH sipas trajtimit të veçantë të kësaj skeme, nuk duhet të merren (blihen) jashtë kushteve dhe kritereve të kësaj skeme, duke u ngarkuar me TVSH jo

në përputhje me kriteret dhe kushtet e parashikuara në këtë udhëzim.

8. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për marrjen e masave për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj